



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4259 prot.

Himarë, më 12.06. 2026

VENDIM

Nr. 19, Datë 04.06.2026

PËR

“DHËNIEN E MIRATIMIT PËR DHËNIEN NË PËRDORIM PËR NJË AFAT 3 (TRE) VJEÇAR, NGA FONDI PYJOR KULLOSOR TË NJË SIPËRFAQE PREJ 1.74 HA NË EKONOMINË PYJORE “MALI I PILURIT ÇIKË”, NGA STRA 69, ZK:3813 NË FAVOR TË Z. BARDHOSH ÇELOLESKAJ”

AKTIVITETI:

“AGROPYLLTARI”

Bazuar ne ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, pika 1.2; neni 27, pika 5 dhe nenit 54; VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive”, ligjin 57/2020, date 30.04.2020 “Për Pyjet”, neni 5; VKM nr. 592, datë 09.10.2018 "Për disa ndryshime në VKM nr.1354, date 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”; V.K.M-në nr.888, datë 27.12.2022, “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit , procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre. Me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Himarë, Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 04.06.2026, miratoi me 17 (shtatëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim dhe si më poshtë:

VENDOSI:

1. Dhënie e miratimit për dhënie në përdorim për një afat 3 (tre) vjeçar, nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 1.74 ha në ekonominë pyjore “Mali i Pilurit Çikë”, nga str. 69, zk:3813 në favor të z. Bardhosh Çeloleskaj për aktivitetin “AGROPYLLTARI”.

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Himarë dhe administrata, për përgatitjen dhe nënshkrimin e kontratës “Për dhënien në përdorim për një afat 3 (tre) vjeçar, nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 1.74 ha në ekonominë pyjore “Mali i Pilurit Çikë”, ngastra 69, zk:3813 në favor të z. Bardhosh Çeloleskaj për aktivitetin “AGROPYLLTARI”.

3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55 pika 6.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

